
Pyetësor për vlerësimin e njohurive të nëpunësve
pranë Autoriteteve Publike, lidhur me të drejtën
për mbrojtjen e të dhënave personale në
Republikën e Shqipërisë

Rezultatet



Organizuar në kuadër të 28 Janarit, Ditës Ndërkombëtare të Mbrojtjes së të Dhënave Personale.

Tiranë 2022

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Mbrojtjes së të Dhënave Personale (28 Janar), Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Zyra e Komisionerit”) ka zhvilluar një pyetësor për vlerësimin e njohurive të nëpunësve pranë autoriteteve publike, lidhur me të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale në Republikën e Shqipërisë. Ky pyetësor i është drejtuar autoriteteve publike dhe specifikisht, atyre të cilat përpunojnë sasi të konsiderueshme dhe në mënyrë vazhdueshme të dhëna personale, të shtetasve shqiptarë e të huaj në Republikën e Shqipërisë.

Kjo datë përkon me miratimin e Konventës 108 të Këshillit të Evropës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”, në vitin 1981.

Në vitin 2006, Këshilli i Ministrave të Këshillit të Evropës vendosi kremtimin e “Ditës së Mbrojtjes së të Dhënave Personale” çdo 28 Janar, pasi në këtë datë Konventa 108 e KiE u hap për nënshkrim nga të gjitha vendet anëtare të kësaj organizate. Sot, 28 Janari, celebrohet në shkallë botërore dhe njihet edhe si Dita e Privatësisë.

Ky pyetësor ka synuar vlerësimin e njohurive të administratës publike në lidhje me të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale, kriterëve dhe normave për përpunim e ligjshëm të tyre.

Rezultatet e përfituara nga pyetësori i mundësuan Zyrës së Komisionerit të informohet mbi nivelin e njohjes nga nëpunësit e sektorit publik, të detyrimeve në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, si dhe të evidentojë problematikat më të rëndësishme, duke zbërthyer kështu nevojat për zhvillim profesional dhe për trajnime të mëtejshme të nëpunësve pranë këtyre institucioneve, apo për zhvillim profesional.

Kjo lind si një nevojë e shtuar pasi së shpejti, Shqipëria do të ketë një kuadër të ri rregullator në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, sipas *acquis* të Bashkimit Evropian, të përafëruar tërësisht me Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (GDPR), duke parashikuar standarde më të larta në garantimin e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale.

Metodologjia e hartimit të pyetësorit

Pyetësori u realizua nëpërmjet 21 pyetjeve, të cilat kishin si përgjigje disa alternativa zgjedhjeje. Përmbajtja e pyetësorit, dhe pyetjet konkrete u përpiluan nga Zyra e Komisionerit. Përmbajtja e pyetjeve dhe niveli i njohurive që ato kërkojnë mbi legjislacionin e mbrojtjes së të dhënave personale është i nivelit fillestar.

Subjektet në të cilat u përhap ky pyetësor, kanë qenë institucionet e administratës publike, me numër të ndryshëm nëpunësish, për të vlerësuar tek ata njohuritë në lidhje me të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale, kriterëve dhe normave për përpunim e ligjshëm të tyre. Pyetësori u hartua duke përdorur sistemin *FlexiQuiz* dhe u shpërnda me postë elektronike

përkundrejtë adresës zyrtare të secilit institucion, Koordinatorëve për të Drejtën e Informimit apo Nëpunësve përgjegjës për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të përcaktuar në institucion.

Posta që shoqëronte lidhjen e pyetësorit përmbante gjithashtu shpjegime se, pyetësi duhej plotësuar në mënyrë individuale dhe se ishte anonim, pra nuk identifikon personin që e ka plotësuar, me qëllim që ky pyetësor të plotësohej pa druajtje nga nëpunësit, duke treguar në mënyrë sa më transparente njohuritë e tyre për ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”).

Gjithashtu, në email-in e dërguar për secilin institucion, pati udhëzime që pyetësi të shpërndahej tek të gjithë punonjësit e institucioneve të përfshira në të, dhe veçanërisht tek punonjësit të cilët për shkak të detyrës së tyre funksionale, kryejnë apo përfshihen në mënyrë të pashmangshme përgjatë proceseve të punës, në përpunimin e të dhënave personale. Konkretisht, strukturat dominuese janë, sektori i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, si dhe njësitë përgjegjëse për çështjet juridike apo burimet njerëzore, të cilat për shkak të funksionit, përpunojnë sasi të konsiderueshme të të dhënave personale të shtetasve shqiptarë e të huaj, në Republikën e Shqipërisë.

Struktura e pyetësorit

Në këtë pyetësor janë përfshirë përreth **121** institucione nga sektori publik, duke përfshirë këtu institucionet e pushtetit qendror, institucione të pushtetit vendor, institucione të pavarura si dhe institucione të tjera.


Struktura e pyetësorit është kompozuar me **21** pyetje, të cilat kanë patur për qëllim të zbërthejnë njohuritë e punonjësve të administratës publike mbi konceptin e të dhënave personale, apo ato sensitive, si dhe parimet në të cilat bazohet përpunimi i të dhënave personale.

Gjithashtu i rëndësishëm ishte zërthimi i njohurive mbi konceptet si, pëlqimi i subjektit të të dhënave personale, apo të drejtat që i garanton subjekteve të të dhënave Ligji, etj. Niveli i pyetjeve në përmbajtje të pyetësorit nuk kërkon njohuri të thelluara të kuadrit ligjor në fuqi, por kërkonin një nivel bazik të njohurive në këtë fushë.

Referuar përgjigjeve rezulton se, në këtë pyetësor kanë marrë pjesë 1704 nëpunës publik.

Pjesëmarrësit, të ndarë në përqindje janë përkatësisht: 50% e të pyeturve janë nëpunës të institucioneve të Pushtetit Qendror, 13% e tyre janë pjesë të institucioneve të Pushtetit Vendor, 21% e tyre janë nëpunës të institucioneve të pavarura, dhe 16 % e të pyeturve i përkasin institucioneve të tjera.


Pushteti		
1	Qendror	50%
2	Vendor	13%
3	I pavarur	21%
4	Tjetër	16%
	TOTAL	100%



Pyetjet e shtruara

1. Çfarë janë të dhënat personale?		
A. Çdo e dhënë e vetme, ose në kombinim me informacione të tjera, që mund të identifikojë një individ.		52%
B. Të dhëna historike të publikuara për një monument.		1%
C. Informacion në lidhje me kurrikulën personale të punonjësve.		15%
D. Informacion ose të dhëna që ruhen në një kasafortë.		6%
E. Të dhëna financiare, emri, adresa, kontakti, aktiviteti i ushtruar, faqja zyrtare, NIPT i shoqërisë tregtare.		19%
F. Fotografji – video të qytetarëve të cilët aksesojnë një ambient publik shërbimi.		6%
G. Të dhëna në lidhje me numrin e biçikletave të cilat kalojnë në një rrugë të caktuar.		0%
H. Të dhëna në lidhje me numrin e personave që kanë marrë shërbim në sportelet e ndërmarrjes publike.		1%
TOTAL		100%

Çfarë janë të dhënat personale:




- Lidhur me pyetjen se çfarë janë të dhënat personale rezulton se, përrreth 27% e përgjigjeve të të pyeturve kanë identifikuar alternativa të gabuara si përgjigje të pyetjes së shtruar, duke mos identifikuar saktë se, çfarë janë të dhëna personale.

2. Cila nga të dhënat e mëposhtme do të klasifikohesh si e dhënë personale sensitive?

A. Adresa.	11%
B. Gjendja shëndetësore.	23%
C. Emri.	5%
D. Besimi fetar.	18%
E. Gjendja Penale.	20%
F. Të gjitha të mësipërmet.	23%
TOTAL	100%

Cila nga të të dhënat e mëposhtmet do të klasifikohet si e dhënë personale sensitive:



■ Adresa
 ■ Gjendja shëndetësore
 ■ Emri
■ Besimi fetar
 ■ Gjendja Penale
 ■ Të gjitha të mësipërmet.


- Lidhur me pyetjen se cilat nga të dhënat e mëposhtmet do të klasifikohet si e dhënë personale sensitive, rezulton se 39% e përgjigjeve i janë referuar si të dhëna sensitive disa alternativave të pasakta, konkretisht, adresës 11%, emrit 5% dhe alternativës të gjitha të mësipërmet 23% e të gjithë përgjigjeve.

3. Në dijeninë tuaj, cilat të dhëna personale mund të mbajë ligjërisht punëdhënësi për ju?

A. Emër, mbiemër.	17%
B. Datëlindje.	16%
C. Adresën GPS të telefonit celular.	1%
D. Numrin e celularit.	15%
E. Të dhënat e bankës përfshirë kartën e kreditit.	1%
F. Numrin e llogarisë së bankës.	11%
G. Paswordin tuaj.	0%
H. Shkollën ku keni studiuar.	15%
I. Të dhëna lidhur me shëndetin.	8%
J. Besimin fetar.	0%
K. Bindjen politike.	0%
L. Detaje të jetës seksuale.	0%
M. Pozicionin e punës.	16%
TOTAL	100%

- Në pyetjen e tretë të pyetësorit është kërkuar informacion se, cilat të dhëna personale mund të mbajë ligjërisht punëdhënësi për punonjësit e tij, dhe bazuar në përgjigjet e dhëna rezultoi se, 10% e përgjigjeve identifikojnë të dhëna të pasakta, të cilat mund ti administrojë punëdhënësi si: 1% Adresën GPS të telefonit celular, 1% Të dhënat e bankës përfshirë kartën e kreditit, 8% Të dhëna lidhur me shëndetin.

4. Kur mbledhim të dhënat personale të individëve, duhet:	
A. Të mos mblidhen informacione personale pa kufizim.	11%
B. Të mos mashtrohen individët në lidhje me qëllimet e mbledhjes së të dhënave personale.	13%
C. Të kufizohet sasia dhe lloji i informacionit që mblidhen në atë që nevojitet për qëllimet e identifikuar.	17%
D. Të gjitha të mësipërmet.	59%
TOTAL	100%




- Në pyetjen e katërt të pyetësorit, të anketuarit janë pyetur lidhur me çfarë duhet patur parasysh kur mbledhim të dhënat personale të individëve. Të tre alternativat e vëna në dispozicion janë të sakta, pra në rast se mbledhim të dhëna personale duhet të: 1) Të mos mblidhen informacione personale pa kufizim, 2) Të mos mashtrohen individët në lidhje me qëllimet e mbledhjes së të dhënave personale si dhe 3) Të kufizohet sasia dhe lloji i informacionit që mblidhen në atë që nevojitet për qëllimet e identifikuar.

Bazuar në rezultatet e përgjigjeve të dhëna, 59 % e anketuesëve kanë arritur të evidentojnë se të tre alternativat e dhëna janë të sakta, ndërkohë që 41% e tyre, kanë evidentuar vetëm një të sakta apo dy alternativa të sakta.

5. Çfarë përbën bazë ligjore për përpunimin e të dhënave sipas legjislacionit shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale?

A. Pëlqimi i subjektit të të dhënave.	65.6%
B. Opinioni i Kryeministrit.	0.8%
C. Urdhri i titullarit të institucionit.	33.6%
TOTAL	100%


Çfarë përbën bazë ligjore për përpunimin e të dhënave sipas legjislacionit shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale?



■ Pëlqimi i subjektit të të dhënave ■ Opinioni i Kryeministrit
 ■ Urdhri i titullarit të Institucionit.

- Me anë të kësaj pyetje është synuar kuptueshmëria se sa të informuar janë nëpunësit e administratës publike se, çfarë përbën bazë ligjore për përpunimin e të dhënave sipas legjislacionit shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale. Nga analiza e përgjigjeve rezulton se, përreth 34.4 % e të pyeturve kanë identifikuar në mënyrë të gabuar duke përzgjedhur si alternativë: 1) *Opinionin e Kryeministrit dhe* 2) *Urdhrin e titullarit të Institucionit*, dhe jo alternativën e saktë konkretisht: *Pëlqimin e subjektit të të dhënave*.

6. Një kompani mundet ligjërisht të aksesojë të dhënat tuaja nëpërmjet mekanizmit të pëlqimit në faqen e saj web:	
Duke e marrë menjëherë pëlqimin.	9%
Duke e marrë menjëherë për sa kohë ju mundëson që ti fshini të dhënat tuaja më pas.	3%
Duke treguar një kuti të çekuar e cila ju thotë se jeni dakord me termat dhe kushtet.	22%
Duke shpjeguar se si do të përdoren të dhënat, duke ju kërkuar më pas të klikoni një kuti, e cila demonstroi dhënien e pëlqimit dhe mundëson aksesin në informacion.	66%
TOTAL	100%




- Referuar pyetjes 6, rezulton se 34 % e të pyeturve nëpërmjet pyetësorit, nuk kanë dijeni të qartë se si një kompani mundet ligjërisht të aksesojë të dhënat e tyre nëpërmjet mekanizmit të pëlqimit, në faqen e saj web. Përgjigja korrekte është se, përpara se të marrë pëlqimin kompania mundet të aksesojë të dhënat duke ju shpjeguar fillimisht se si do të përdoren

këto të dhëna, e më pas duke ju kërkuar të klikoni një kuti e cila demonstroi dhënien e pëlqimit dhe mundëson aksesin në informacion.

7. Përpunimi i të dhënave personale duhet të lejohet vetëm kur informacioni personal është i nevojshëm dhe i lidhur me përmbushjen e një kontrate me subjektin e të dhënave?

PO	91%
JO	9%
TOTAL	100%

Përpunimi i të dhënave personale duhet të lejohet vetëm kur informacioni personal është i nevojshëm dhe i lidhur me përmbushjen e një kontrate me subjektin e të dhënave




- Lidhur me pyetjen e shtatë se, kur duhet të lejohet përpunimi i të dhënave personale rezultatet kanë treguar se, 9% e të pyeturve janë përgjigjur me **JO** përkufizimit se: Përpunimi i të dhënave personale duhet të lejohet vetëm kur informacioni personal është i nevojshëm dhe i lidhur me përmbushjen e një kontrate me subjektin e të dhënave, ndërsa 91% e të anketuarve e kanë identifikuar saktë këtë pyetje.

8. Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale nuk mund të aplikohet për:

A. Kategoritë e pagave.	25%
B. Numrat telefonik të institucionit.	47%
C. Punonjësit.	12%
D. Numrat personal të identifikimit ID.	16%
TOTAL	100%


Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale nuk mund të aplikohet për:



- Në 28% (12%+ 16%) të rasteve, nëpërmjet përgjigjeve, nëpunësit kanë përzgjedhur një alternativë të gabuar duke cilësuar se, Ligji nuk mund të aplikohet për 1) *Punonjësit* (12%) dhe 2) *Numrat personal të identifikimit ID* (16%).

9. Kur mund të vihen në dispozicion të një pale të tretë, të dhënat personale të një qytetari?

A. Ku pala e tretë është një pjesëtar i familjes së qytetarit.	7%
B. Kur është marrë pëlqimi i qytetarit.	86%
C. Kur pala e tretë premtan se do të garantojë pëlqimin e qytetarit.	7%
TOTAL	100%




- Në 14 % të përgjigjeve, të anketuarit mendojnë se, të dhënat personale të një qytetari mund të vihen në dispozicion të një pale të tretë, kur pala e tretë është një pjesëtar i familjes së qytetarit apo kur pala e tretë premtan se do të garantojë pëlqimin e qytetarit. Ndërsa 86 % janë përgjigjur saktë duke identifikuar se, vetëm kur është marrë pëlqimi i qytetarit, mund të vihen në dispozicion të një pale të tretë të dhënat personale të tij.

10. Një mik i familjes ju kërkon miqësisht një informacion në lidhje me dokument specifik që përmban, ndër të tjera, edhe të dhëna personale të një të afërmi të vet, për të cilat ju keni akses për shkak të pozicionit të punës.

A. Do ta ndihmonit mikun tuaj.	1%
B. Do t'i kërkonit që subjekti i të dhënave të paraqitej vetë pranë institucionit tuaj.	44%
C. Do t'i kërkonit akt përfaqësimi / prokurë për akses në të dhënat personale.	55%
TOTAL	100%

Një mik i familjes ju kërkon miqësisht një informacion në lidhje me dokument specifik që përmban ndër të tjera edhe të dhëna personale të një të afërmi të vet, për të cilat ju keni akses për shkak të pozicionit të punës



- Në këtë pyetje, 99% e të anketuarve kanë përzgjedhur alternativat e sakta duke shprehur se, në rast se, një mik i familjes i kërkon një informacion në lidhje me dokument specifik që përmban ndër të tjera edhe të dhëna personale të një të afërmi të vet, për të cilat ata kanë akses për shkak të pozicionit të punës, fillimisht do t'i kërkojnë që subjekti i të dhënave të paraqitej vetë pranë institucionit ose do t'i kërkonin akt përfaqësimi / prokurë për akses në të dhënat personale.

11. Në bazë të planifikimit të orareve për shmangien e turmave gjatë ofrimit të shërbimit, institucioni krijon një axhendë referuar aplikantëve. Aplikantët njoftohen në adresat e tyre personale të emailit, në grup (cc), duke bashkëlidhur një tabelë në exel e cila përmban të dhënat e të gjithë aplikantëve, emër, mbiemër, adresat email, shërbimet e kërkuara për çdo aplikant, datën dhe orën e paraqitjes në sportel, etj. Gjeni alternativën e saktë.

A. Komunikimi i aplikantëve me email në grup nuk përbën shkelje.	11.98%
B. Përhapja e dokumentit në formatin exel që përmban të dhënat e aplikantëve nuk përbën shkelje.	3.36%
C. Të dhënat e aplikantëve si emër, mbiemër, adresat email, shërbimet e kërkuara për çdo aplikant, datën dhe orën e paraqitjes në sportel, nuk janë të dhëna personale ndaj përhapje a tyre nuk përbën shkelje.	15.34%
D. Të gjitha alternativat e mësipërme janë shkelje.	69.32%
TOTAL	100%


- Në 30.68% të përgjigjeve, nuk kanë arritur të identifikojnë në mënyrë të plotë se, njoftimi nëpërmjet emaili-it të një axhendë me aplikantë, në adresat e tyre personale të emailit, në grup (cc), duke bashkëlidhur një tabelë në exel e cila përmban të dhënat e të gjithë aplikantëve (emër, mbiemër, adresat email, shërbimet e kërkuara për çdo aplikant, datën dhe orën e paraqitjes në sportel), përbën shkelje të Ligjit, pasi të anketuarit nuk i kanë përzgjedhur të gjithë alternativat e sakta por vetëm një ose dy prej tyre.

12. Për pohimet e mëposhtme, përzgjidhni ato që janë të sakta:

A. Unë kam të drejtë të jem i informuar në lidhje me të dhënat që mblidhen rreth meje.	27%
B. Unë kam të drejtë të kem akses në të dhënat e mbledhura rreth meje.	18%
C. Unë kam të drejtë të refuzoj të dhënat e mbledhura rreth meje.	11%
D. Unë kam të drejtë të fshijë të dhënat e mbledhura rreth meje.	6%
E. Unë kam të drejtë të refuzoj ruajtjen e të dhënave rreth meje.	9%
F. Të gjitha të mësipërmet.	29%
TOTAL	100%

Për pohimet e mëposhtme, përzgjidhni ato që janë të sakta:

- Unë kam të drejtë të jem i informuar në lidhje me të dhënat që mblidhen rreth meje
- Unë kam të drejtë të kem akses në të dhënat e mbledhura rreth meje
- Unë kam të drejtë të refuzoj të dhënat e mbledhura rreth meje
- Unë kam të drejtë të fshijë të dhënat e mbledhura rreth meje
- Unë kam të drejtë të refuzoj ruajtjen e të dhënave rreth meje



- Në vetëm 29% të rasteve të anketuarit në përgjigjet e tyre kanë arritur t'i evidentojnë të gjithë alternativat e sakta, që përkojnë me të drejtat e subjektit të të dhënave, të garantuara nga Ligji.

13. Cila është mënyra më e mirë për të vërtetuar një postë elektronike të ligjshme kundrejt një postë elektronike jo të ligjshme?


A. Drejtshkrimi i keq, sintaksa e dobët dhe gramatika janë disa nga shenjat treguese të një emaili të rremë.	9%
B. Titujt e emailit për të parë se nga erdhi në të vërtetë.	13%
C. Logo të përsëritura dobët.	7%
D. Kontaktimi me dërguesin përveç emailit për të verifikuar nëse ju ka dërguar emailin.	26%
E. Të gjitha të mësipërmet.	45%
TOTAL	100%

- Në 55 % të rasteve të përgjigjeve të anketuesve nuk kanë evidentuar plotësisht se, cila është mënyra më e mirë për të vërtetuar një postë elektronike të ligjshme kundrejt një postë elektronike jo të ligjshme (9% mendojnë se, është drejtshkrimi i keq, sintaksa e dobët dhe gramatika janë disa nga shenjat treguese të një emaili të rremë, 13% mendojnë se titujt e emailit për të parë se nga erdhi në të vërtetë, 7% Logo të përsëritura dobët, 26% Kontaktimi me dërguesin përveç emailit për të verifikuar nëse ju ka dërguar emailin). Ndërsa 45% kanë përzgjedhur alternativën e saktë: të gjithë alternativat e sipërcituara, pasi të gjithë elementët e sipërcituar janë të rëndësishëm për të identifikuar apo vërtetuar një postë elektronike jo të ligjshme.

14. Sa shpesh duhet të bëni kopje rezervë të të dhënave tuaja?

A. Një herë në javë.	1%
B. Një herë në dy javë.	1%
C. Njëherë në muaj.	3%
D. Në përputhje me politikën e miratuar të Institucionit tuaj.	95%
TOTAL	100%

Sa shpesh duhet të bëni kopje rezervë të të dhënave tuaja?



- Në analizë të pyetjes “*Sa shpesh duhet të bëni kopje rezervë të të dhënave tuaja*”, në 95 % të rasteve të anketuarit janë përgjigjur korrekt duke u shprehur se, bëjnë kopje rezervë të të dhënave të tyre në përputhje me politikën e miratuar të institucionit, ndërsa në 5% të rasteve, të anketuarit janë përgjigjur jo korrekt, konkretisht, 1% një herë në javë, 1% një herë në dy javë si dhe 3% njëherë në muaj.

15. Cila nga alternativat në vijim ndihmon për sigurinë e fjalëkalimit/ passwordit të postës elektronike apo pajisjeve të tjera kompjuterike?


A. Përdorimi i një software për menaxhimin e fjalëkalimit për ta ruajtur në mënyrë të sigurt password-in tuaj të hyrjes.	17.39%
B. Shkrimi i fjalëkalimeve me një shënim ngjitës që mbani pranë kompjuterit tuaj.	1.44%
C. Ndryshimi i fjalëkalimeve tuaja duke u bazuar në rregullore dhe manual të miratuar nga organet kompetente, si për shembull çdo tre deri në gjashtë muaj.	45.49%
D. Krijimi i fjalëkalimeve unike, të gjata, komplekse për çdo llogari në internet që keni.	35.67%
TOTAL	100%

- Lidhur me elementet që ndihmojnë për sigurinë e fjalëkalimit/ passwordit të postës elektronike apo pajisjeve të tjera kompjuterike, në 18.83 % të rasteve të anketuarit kanë përzgjedhur alternativa jo të sakta, ndërsa në 81.17 % të përgjigjeve, të anketuarit kanë përzgjedhur dy alternativa të sakta, konkretisht 45.45% kanë zgjedhur: "*Ndryshimi i fjalëkalimeve tuaja duke u bazuar në rregullore dhe manual të miratuar nga organet kompetente, si për shembull çdo tre deri në gjashtë muaj*" si dhe 35.67% kanë zgjedhur "*Krijimi i fjalëkalimeve unike, të gjata, komplekse për çdo llogari në internet që keni*".

16. Kush janë objektivat e hakerëve për marrjen e të dhënave personale në ditët e sotme?

A. Bankat dhe kompanitë financiare që përpunojnë të dhëna financiare të klientëve.	16%
B. Çdo organizatë ose individ.	4%
C. Kompanitë që mbajnë shumë informacione të individëve.	10%
D. Kompanitë që mbajnë të dhëna të klientëve të kartave të kreditit etj.	15%
E. Të gjitha të mësipërmet.	55%
TOTAL	100%

Kush janë objektivat e hakerëve për marrjen e të dhënave personale në ditët e sotme?




- Lidhur me pyetjen se, cilat janë objektivat e hakerëve për marrjen e të dhënave personale në ditët e sotme, në përgjigjet e dhëna në pyetësor, 55% e tyre kanë evidentuar të gjithë alternativat e sakta, ndërsa në 45% të rasteve nga ana e anketuesve është përzgjedhur njëra nga alternativat që gjithsesi është e saktë, por është një përgjigje e paplotë.

17. Masat organizative duhet të mbrojnë të dhënat personale me cilën prej metodave të mëposhtme:

A. Masat fizike, për shembull, copëtimi i dokumenteve që përmbajnë informacione mbi të dhënat personale, dhe mbyllja e dokumenteve në vende të sigurta.	6%
B. Masat organizative të miratuara, për shembull, lejet e sigurisë dhe kufizimit të aksesit mbi bazën e të dhënave ku administrohen të dhënat personale.	17%
C. Masat teknologjike, për shembull, përdorimi i fjalëkalimeve të enkriptuara.	13%
D. Të gjitha të mësipërmet.	64%
TOTAL	100%

Masat organizative duhet të mbrojnë të dhënat personale




- Masat fizike, për shembull, copëtimi i dokumenteve që përmbajnë informacione mbi të dhënat personale, dhe mbyllja e dokumenteve në vende të sigurta.
- Masat organizative të miratuara, për shembull, lejet e sigurisë dhe kufizimit të aksesit mbi bazën e të dhënave ku administrohen të dhënat personale
- Masat teknologjike, për shembull, përdorimi i fjalëkalimeve të enkriptuara
- Të gjitha të mësipërmet

- Referuar përgjigjeve të pyetjes 17, se me cilën prej metodave, masave organizative duhet të mbrojnë të dhënat personale, të anketuarit në 64% të përgjigjeve i kanë identifikuar në mënyrë të plotë të gjitha masat: 1. *Fizike*, 2. *Masat organizative të miratuara* si dhe 3. *Masat teknologjike*.

18. A ju është dashur ndonjëherë që për shkak të pozicionit të punës, të nënshkruani një deklaratë për ruajtjen e konfidencialitetit?

PO	61%
JO	39%
TOTAL	100%

A ju është dashur ndonjëherë që për shkak të pozicionit të punës, të nënshkruani një deklaratë për ruajtjen e konfidencialitetit




- 61 % e përgjigjeve të të anketuarve pohojnë se u është dashur që për shkak të pozicionit të punës, të nënshkruajnë një deklaratë për ruajtjen e konfidencialitetit, ndërsa 39% e tyre deklarojnë së nuk ju është dashur asnjëherë të nënshkruajnë një deklaratë të tillë.

19. A keni marrë pjesë në trajnime për njohjen me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale?

PO	20%
JO	80%
TOTAL	100%

A keni marrë pjesë në trajnime për njohjen me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale?




■ PO, KANË MARRË PJESË ■ JO, NUK KANË MARRË PJESË

- Bazuar në rezultatet e pyetësorit, rezulton se, nga të gjithë të anketuarit që i janë përgjigjur kësaj pyetje, vetëm 20% e tyre kanë marrë pjesë në trajnime për njohjen me Ligjin.

20. Në dijeninë tuaj, cilët institucione duhet të veprojnë në përputhje me detyrimet e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale:

A. Të gjitha institucionet publike dhe kompani private.	96%
B. Vetëm institucionet publike.	4%
C. Vetëm kompani private.	0%
TOTAL	100%

Në dijeninë tuaj, cilët institucione duhet të veprojnë në përputhje me detyrimet e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale:





- Bazuar në pyetjen e mësipërme, rezultojnë se, të anketuarit në 96 % të përgjigjeve rezultojnë se janë të informuar se, të gjitha institucionet publike dhe kompanitë private duhet të nënshtrohen detyrimeve të Ligjit, ndërsa në 4% të rasteve të anketuarit mendojnë se vetëm institucionet publike duhet të veprojnë në përputhje me detyrimet e këtij Ligji.

21. Kush është përgjegjës për zbatimin e detyrimeve të parashikuara në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale?

A. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.	76%
B. Kontrolluesi i të dhënave personale.	11%
C. Subjekti i të dhënave.	8%
D. Policia e Shtetit.	5%
TOTAL	100%

Kush është përgjegjës për zbatimin e detyrimeve të parashikuara në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale



- Në 89 % të rasteve, të anketuarit nuk kanë identifikuar saktë se, kush është përgjegjës për zbatimin e detyrimeve të parashikuara në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke përzgjedhur alternativat e gabuara si: 76% Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, 8% Subjekti i të dhënave dhe 5% Policia e Shtetit, ndërkohë që Ligji ngarkon kontrolluesin me këtë detyrim.

KONKLuzionet e Pyetësorit

- 1) 27% e të anketuarve nuk kanë identifikuar në mënyrë shteruese, se çfarë përbëjnë të dhënat personale.
- 2) 39% e të anketuarve mendojnë se, pjesë e të dhënave sensitive janë edhe disa alternativave të pasakta konkretisht (adresa dhe emri).
- 3) 10% të anketuarve, bazuar në rezultatet e anketës mendojnë se, punëdhënësi mund të administrojë ligjërisht për punonjësit e tij, të dhëna personale si: 1% adresën GPS të telefonit celular, 1% të dhënat e bankës përfshirë kartën e kreditit, 8% të dhëna lidhur me shëndetin, të cilat faktikisht janë në kundërshtim me parimet mbi të cilat bazohet përpunimi i të dhënave personale, të përcaktuara në nenin 5 të Ligjit.
- 4) 41% e të anketuarve nuk kanë identifikuar në mënyrë të plotë parimet mbi të cilat bazohet përpunimi i të dhënave personale, ndërsa 59% e përgjigjeve kanë arritur të evidentojnë të tre alternativat e sakta. *(1. Të mos mblidhen informacione personale pa kufizim, 2. Të mos mashtrohen individët në lidhje me qëllimet e mbledhjes së të dhënave personale si dhe 3. Të kufizohet sasia dhe lloji i informacionit që mblidhen në atë që nevojitet për qëllimet e identifikuar).*
- 5) 34.4 % e përgjigjeve kanë identifikuar në mënyrë të gabuar pyetjen se, çfarë përbën bazë ligjore për përpunimin e të dhënave sipas legjislacionit shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale duke përzgjedhur alternativa të gabuara si: 1) *Opinionin e Kryeministrit* dhe 2) *Urdhrin e titullarit të Institucionit*.
- 6) 34 % e të anketuarve nuk kanë dijeni të qartë se, një kompani mundet ligjërisht të aksesojë të dhënat e subjektit të të dhënave duke ju shpjeguar fillimisht se si do të përdoren këto të dhëna, e më pas duke ju kërkuar dhënien e pëlqimit që mundëson aksesin në informacion.
- 7) 9% e të pyeturve nëpërmjet pyetësorit nuk kanë dijeni se, Përpunimi i të dhënave personale duhet të lejohet vetëm kur informacioni personal është i nevojshëm dhe i lidhur me përmbushjen e një kontrate me subjektin e të dhënave, ndërsa 91% e të anketuarve e kanë identifikuar saktë këtë pyetje.
- 8) 28% e të anketuarve nuk kanë njohuri se, Ligji mund të aplikohet për punonjësit dhe numrat personal të identifikimit ID.
- 9) 14% e të anketuarve mendojnë në mënyrë jo të saktë se, të dhënat personale të një qytetari mund t'i vihen në dispozicion të një pale të tretë, kur pala e tretë është një

pjesëtar i familjes së qytetarit apo kur pala e tretë premtan se, do të garantojë pëlqimin e qytetarit. 86 % janë përgjigjur saktë duke identifikuar se, *vetëm kur është marrë pëlqimi i qytetarit mund të vihen në dispozicion të një pale të tretë, të dhënat personale të një qytetari.*

- 10) 99% e të anketuarve janë të qartë mbi veprimet që duhet të kryejnë në rast se, një mik i familjes i kërkon një informacion në lidhje me dokument specifik që përmban ndër të tjera edhe të dhëna personale të një të afërmi të vet, për të cilat ata kanë akses për shkak të pozicionit të punës, fillimisht do t'i kërkojnë që subjekti i të dhënave të paraqitej vetë pranë institucionit ose do t'i kërkonin akt përfaqësimi / prokurë për akses në të dhënat personale.
- 11) 30.68% e përgjigjeve të të anketuarve nuk janë të informuar se, njoftimi nëpërmjet emaili-it, të një axhende me aplikantë, në adresat e tyre personale të email-it, në grup (cc), duke bashkëlidhur një tabelë në excel e cila përmban të dhënat e të gjithë aplikantëve, (emër, mbiemër, adresat email, shërbimet e kërkuara për çdo aplikant, datën dhe orën e paraqitjes në sportel), përbën shkelje në bazë të Ligjit.
- 12) 29% e të anketuarve kanë dijeni të saktë mbi të drejtat e subjektit të të dhënave, të garantuara nga Ligji, ndërsa 71% e tyre kanë njohuri të pjesshme mbi këto të drejta.
- 13) 55% e përgjigjeve të të anketuarve nuk kanë evidentuar në mënyrë të plotë të gjithë elementët që ndihmojnë për të vërtetuar një postë elektronike të ligjshme kundrejt një postë elektronike jo të ligjshme.
- 14) 95% të rasteve anketuesit janë përgjigjur korrekt duke u shprehur se, bëjnë kopje rezervë të të dhënave të tyre në përputhje me politikën e miratuar të institucionit, ndërsa 5% të rasteve anketuesit janë përgjigjur jo korrekt.
- 15) 81.17% e të anketuarve janë të informuar lidhur me elementet që ndihmojnë për sigurinë e fjalëkalimit / passwordit të postës elektronike apo pajisjeve të tjera kompjuterike, ndërsa 18.83 % kanë dijeni të pasaktë lidhur me këto elementë.
- 16) 55% e të anketuarve kanë dijeni të plotë mbi objektivat e hakerëve për marrjen e të dhënave personale në ditët e sotme, ndërsa 45% e përgjigjeve kanë dijeni jo të plotë.
- 17) 36% e të anketuarve kanë informacion jo të plotë mbi masat organizative që duhet të ndërmerret kontrolluesi për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, ndërsa 64% e të anketuarve i kanë identifikuar në mënyrë të plotë të gjitha masat.
- 18) 61% e përgjigjeve të të anketuarve pohojnë se u është dashur që për shkak të pozicionit të punës, të nënshkruajnë një deklaratë për ruajtjen e konfidencialitetit, ndërsa 39% e tyre deklarojnë se nuk ju është dashur asnjëherë të nënshkruajnë një

deklaratë të tillë.

- 19) Vetëm 20% e të anketuarve kanë marrë pjesë në trajnime për njohjen me Ligjin.
- 20) 96% e të anketuarve janë të informuar se, të gjitha institucionet publike dhe kompanitë private duhet ti nënshtrohen detyrimeve të Ligjit.
- 21) 89 % e të anketuarve nuk janë në gjendje të identifikojnë se kush është përgjegjës për zbatimin e detyrimeve të parashikuara në Ligj.

PROBLEMATIKAT E EVIDENTUARA

Sikundër është përkufizuar edhe në fillim të pyetësorit, qëllimi i rezultateve të përfituara nga ky pyetësor ka qenë krijimi nga ana e Zyrës së Komisionerit të një panorame mbi nivelin e njohurive të nëpunësve të sektorit publik në Shqipëri, mbi Ligjin, dhe institutet e përfshira në përmbajtje të tij. Evidentimi i problematikave më të rëndësishme ka zbërthyer më pas dhe nevojat për trajnime të mëtejshme, apo për zhvillim profesional në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale për nëpunësit e sektorit publik. Problematikat kryesore të evidentuara janë:

- Mungesa e trajnimeve mbi Ligjin, veçanërisht për punonjësit të cilët në detyrat e tyre funksionale kryejnë apo përfshihen në përpunimin e të dhënave personale në mënyrë të vazhdueshme, mbi detyrimet që ata mbartim për mbrojtjen e të dhënave personale për shkak të detyrës që ushtrojnë, si dhe zbatimin në mënyrë të unifikuar të detyrimeve që ky Ligj mbart.
- Mungesa e dijes në lidhje me fushën e zbatimit të Ligjit.
- Njohuri të kufizuara mbi disa nga përkufizimet kryesore të këtij ligji si: *“Të dhëna personale”, “Të dhëna sensitive”, “Kontrollues” “Përpunues”, “Përpunim i të dhënave personale”, “Përhapje”, “Pëlqim i subjekteve të të dhënave”,* etj.
- Mungesa e informacionit mbi parimet bazë në të cilët bazohet përpunimi i të dhënave personale (a. përpunimin në mënyrë, të drejtë dhe të ligjshme; b. në grumbullimin për qëllime specifike.. c. në mjaftueshmërinë e të dhënave.. , ç. në saktësinë që të dhënat duhen të kenë,.. etj.).
- Njohuri jo të plota mbi kriteret ligjore të përpunimit të të dhënave personale dhe rastet se kur mund të përpunohen të dhënat personale.

- Informacioni i cunguar mbi të drejtat e subjekteve të të dhënave që garanton Ligji (e drejta për akses, e drejta për të kërkuar bllokimin korrigjimin ose fshirjen, e drejta për të kundërshtuar...etj.) si dhe detyrimet e kontrolluesit dhe të përpunuesit që sanksionon ky Ligj.
- Nivel i kufizuar i njohurive mbi Masat për Sigurinë e të Dhënave Personale që duhet të ndërmerret Kontrolluesi ose Përpunuesi (por pa përjashtuar edhe nëpunësit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre ditore), dhe prezantimi i këtyre masave nga ana e institucioneve publike, punonjësve që cilët kryejnë apo përfshihen në përpunimin e të dhënave personale, më qëllim zbatimin e tyre.

NEVOJAT PËR ZHVILLIM PROFESIONAL DHE PËR TRAJNIME TË MËTEJSHME TË NËPUNËSVE TË KËTYRE INSTITUCIONEVE

Mbështetur në rezultatet e pyetësorit vihet re në mënyrë të dukshme mungesa e trajnimeve të vazhdueshme, veçanërisht për punonjësit të cilët për shkak të detyrës funksionale kryejnë apo përfshihen në përpunimin e të dhënave personale, megjithëse kjo përbën edhe një detyrim ligjor për kontrolluesit dhe përpunuesit sipas përcaktimeve të nenit 27, të Ligjit.

Në bazë dhe për zbatim të këtij neni, Zyra e Komisionerit, ka nxjerrë gjithashtu Vendim nr. 6, datë 05.08.2013, “*Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale*”, ku parashikohen disa rregulla të detyrueshme për tu zbatuar nga kontrolluesit publikë dhe privatë gjatë përpunimit të të dhënave personale, dhe konkretisht në pikën 4 përcaktohet se, *Kontrolluesi detyrohet të ndërmarrë hapat e nevojshëm dhe të garantojë që stafi të jetë i ndërgjegjësuar dhe i trajnuar rreth nevojës së sigurisë dhe përforcimit të saj.*

Gjithashtu përmes udhëzimit nr. 47 datë 14.09.2018, për “*Përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha*”, në Kreun IV të tij, Zyra e Komisionerit ka përcaktuar detyrimin e kontrolluesit për trajnimin e personelit të subjekteve përpunuese të të dhënave personale dhe dokumentimin e këtij procesi.

Njëkohësisht, duke u bazuar nga aktiviteti mbikëqyrës dhe monitorues i Zyrës së Komisionerit, por edhe nga përfundimet e nxjerra nga përgjigjet e pyetësorit, evidentohet nevoja e pashmangshme për marrjen e njohurive, duke zhvilluar trajnime, në lidhje me kuadrin ligjor në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, pasi mungesa e njohurive më të thelluara mund të çojë potencialisht në shkelje të detyrimeve ligjore dhe përpunim të paligjshëm të të dhënave personale, e për pasojë mos garantimin e të drejtave të individit për mbrojtjen e të dhënave personale të tij, si një garanci e sanksionuar edhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në nenin 35 të saj.

Nevojat për trajnim renditen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

- Trajnime të gjithë nëpunësve të autoriteteve publike, lidhur me njohuritë bazë të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale;
- Trajnim të thelluar stafeve të dedikuara mbi legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe detyrimet që ata mbartim për shkak të detyrës që ushtrojnë si, sektori i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit si dhe njësitë përgjegjëse për çështjet juridike apo burimet njerëzore, të cilat përgjatë përmbushjes së detyrës së tyre funksionale, përpunojnë sasi të konsiderueshme dhe në mënyrë vazhdueshme të dhëna personale të shtetasve shqiptarë e të huaj në Republikën e Shqipërisë;
- Trajnime profesionale, të specializuara dhe vazhduese për nëpunësin e mbrojtjes së të dhënave të caktuar pranë kontrolluesve publik.



DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Rr. "Abdi Toptani", Nd. 5, 1001, Tiranë
info@idp.al; www.idp.al



Tiranë 2022